

# RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS SË KRYETARIT

(janar – qershor 2026)



QERSHOR 2026

---

<b>ZYRA E KRYETARIT .....</b>	<b>6</b>
Zyra Ligjore.....	6
Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit .....	6
Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura.....	7
Zyra për Informim.....	9
Lektorimi.....	10
Zyra e Auditimit të Brendshëm .....	10
Zyra e Prokurimit.....	10
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.....	10
<b>DREJTORIA PËR ADMINISTRATË .....</b>	<b>11</b>
<b>DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET .....</b>	<b>12</b>
<b>DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE.....</b>	<b>14</b>
<b>DREJTORIA PËR ARSIM.....</b>	<b>15</b>
<b>DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT .....</b>	<b>17</b>
Spektori i Urbanizmit dhe i Planifikimit .....	17
<b>DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE .....</b>	<b>18</b>
<b>DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL .....</b>	<b>18</b>
<b>DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....</b>	<b>19</b>
<b>DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT .....</b>	<b>19</b>
<b>DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE.....</b>	<b>20</b>
<b>DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM.....</b>	<b>21</b>

## Fjala hyrëse

*Qytetarë të komunës së Rahovecit,*

*Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2026, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmuajor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – qershor 2026.*

*Raporti pasqyron aktivitetet dhe angazhimet Kryetarit, të drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësitëve të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.*

*Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, përparimin e arritur në realizimin e prioritetëve të Komunës, ballafaqimeve me vështirësitë dhe përpjekjet për t'u dhënë zgjidhje një sërë çështjesh me interes publik dhe ka si pikë reference Programin Qeverisës.*

### **ZOTIMET**

---

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

### **PRIORITETET PËR VITIN 2026:**

---

- Përfundimi i Sheshit Qendror të Qytetit;
- Përfundimi i Ballkonit Panoramik;
- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
- Plotësim-ndryshimi i rregulloreve të Komunës së Rahovecit;
- Plotësim-ndryshimi i Statutit të Komunës së Rahovecit, përfshirë edhe logon;
- Përfundimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturore-artistike dhe klubeve sportive;
- Rritje e subvencionimit për projekte kulturore-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Promovimi i turizmit dhe forcimi i sektorit të bujqësisë në komunën e Rahovecit;

- Krijim i kushteve për operim të bizneseve lokale (infrastrukturë në përputhje me PZhK-në dhe HZK-në);
- Punë praktike me pagesë për të rinjtë;
- Zgjerim i bashkëpunimit me qendrat grumbulluese dhe përpunuese të perimeve dhe të rrushit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2026-2030;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, për tregtinë, për zejet e veçanta, për artizanalet etj.;
- Realizim i planit të të hyrave komunale;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;
- Bashkëpunim me OJQ-të, bizneset dhe grupet e interesit;
- Rrugë fushore të reja dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese;
- Përkrahje për fermerët me farëra dhe inpute bujqësore;
- Projekte dhe investime konkrete për digjitalizimin e bujqësisë;
- Shërbime veterinarë periodike falas;
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore;
- Përkrahje financiare me bursa për studentët dhe nxënësit e dalluar të komunës;
- Bibliotekat - kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete - do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Tabela digjitale në shkolla;
- Rritja e përkrahjes nga 500 euro sa ishte në vitin 2025 në 600 euro për çdo lindje në maternitetin e Rahovecit për vitin 2026;
- Sigurimi shëndetësor për fëmijët në çerdhe;
- Rritje e numrit dhe e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional;
- Funkcionalizimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KRU "Gjakova" dhe me donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne;

## **SYNIMET PËR VITIN 2026:**

---

- Politika të favorshme për investitorët nga mërgata dhe investitorët në sektorin e energjisë së ripërtërishme.
- Përkrahje për bizneset lokale me hapësira të reja, inkubatorë biznesi dhe bashkëfinancim të ideve inovative, me fokus gratë dhe të rinjtë.
- Zhvillim ekonomik dhe punësim përmes fuqizimit të sektorit privat.
- Investime për zhvillimin e agroturizmit.
- Projekte me partneritet publiko-privat.
- Projekte dhe investime konkrete për digjitalizimin e bujqësisë;
- Mirëmbajtje dhe hapje e rrugëve fushore për fermerët.
- Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore.
- Subvencionim i fermerëve me farëra, plehra dhe makineri bujqësore.
- Intensifikimi i punimeve për funksionalizimin e qendrës së magazinimit (depos) bujqësore.
- Përfundimi i ndërtimit të shkollave të reja.
- Arsimit cilësor përmes pajisjes së shkollave me laboratorë, teknologji informative dhe mjete bashkëkohore mësimore.
- Modernizimi dhe pasurimi i bibliotekave shkollore.
- Zgjerimi i listës së barnave esenciale.
- Pajisja e QMF-ve me aparate EHO.
- Mbështetje për punësimin e mjekëve të rinj.
- Modernizimi i shërbimeve stomatologjike dhe diagnostike.
- Investime në pajisje mjekësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
- Fushata ndërgjegjësuese për barazi gjinore dhe përfshirje sociale.
- Pastrimi i ujërave dhe i përrenjve.
- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.
- Eliminimi i deponive ilegale dhe krijimi i lokacioneve të përshtatshme për deponim.
- Vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrenjve.
- Investime për mbrojtje nga vërshimet.
- Rritja e të hyrave vetanake përmes lejeve ndërtimore dhe lejeve mjedisore.
- Legalizimi i objekteve pa leje në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse.
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara.
- Mbështetje për procesin e legalizimit të objekteve pa leje.
- Përmirësimi i menaxhimit të pronës komunale.
- Zbatimi i legjislacionit për trajtimin e objekteve pa leje.
- Mbikëqyrja e respektimit të standardeve mjedisore dhe urbanistike.
- Kontrolli dhe parandalimi i deponive ilegale.
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast fatkeqësish natyrore dhe emergjencash të tjera.
- Ngritja e kapaciteteve lokale për reagim ndaj krizave dhe vërshimeve.
- Përmirësimi i efikasitetit administrativ dhe i shërbimeve për qytetarët.
- Mbështetje institucionale për zbatimin e planeve zhvillimore dhe koordinimin ndërdrejtorial.
- Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe digjitalizimit të shërbimeve komunale.

## **SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2026**

---

- **MUNGESA E MJETEVE FINANCIARE SI PASOJË E OBLIGIMEVE QË RRJEDHIN NGA PROCEDURAT PËRMBARIMORE DHE KONTRATAT KOLEKTIVE NË SEKTORIN E ARSIMIT (4,541,987.40€)**
- Realizimi i projekteve strategjike në përputhje me planifikimin buxhetor dhe objektivat zhvillimore të komunës.
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset konsultative dhe vendimmarrëse;
- Tërheqja e investimeve dhe mbështetjes nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë;
- Menaxhimi efikas i pronës dhe aseteve komunale;
- Nxitja e zhvillimit ekonomik lokal dhe krijimi i mundësive për punësim;
- Inkasimi i të hyrave nga taksat komunale;
- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për realizimin e prioriteteve zhvillimore të komunës;
- Përballimi i sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike dhe eficiencën e energjisë;

## ZYRA E KRYETARIT

### Zyra Ligjore

---

Vendime për Kryetarin e Komunës	213
Vendime për Kuvendin e Komunës	43
Urdhëresa	32
Rregullore	2
Kontrata	13
Autorizime	7
Ankesa	1
Akte përcjellëse	15
Marrëveshje – memorandum mirëkuptimi	3
Propozime për Kuvend	7
Mendime juridike	2
Konsultime	permanente
Kërkesa	3
Përgjigje në kërkesë	2
Vendime për drejtori	10
Punë në komisione	10
<b>Totali i akteve të hartuara:</b>	<b>363</b>

### Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Janë shpallur 18 konkurse publike, prej të cilave 2 në Shërbimin Civil, 13 konkurse në Drejtorinë për Arsim, si dhe 3 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Janë hartuar gjithsej 260 shkresa administrative, si në vijim: kontrata, vërtetime, vendime, draft-vendime, propozime, aktemërime, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera, si dhe ka dërguar mbi 180 emaile zyrtare;

Monitorimi i vijueshmërisë së shërbyesve civilë në punë;

Hartimi i planit të trajnimit të nëpunësve civilë.

Njësia e Personelit menaxhon me programin elektronik *HRMIS*; menaxhon me programin elektronik: *hrms.rks.gov-net*, ku realizohen procedurat e rekrutimit; monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë, të punëtorëve (sistemi SMVP); menaxhon (një pjesë) me programin *SMAED*; monitoron me programin elektronik SMO – program për menaxhimin e listave të pagave dhe pagesave mujore.

## Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

1. Pasqyra tabelore (si më poshtë) për të gjitha regjistrat, paraqet lëndë në punë, të pranuar, të kryera, të pakryera dhe lëndë të mbetura, si dhe pasqyra për veprimet e ndërmarra.

PASQYRA TABELORE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE								
	Sipas regjistrave të ZPL-së	Civile	Përbarimore	Konflikt administrativ	CN të ndryshme	Proc. at _hezionit	Komerciale ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara:
1	Lëndë të pazgjidhura-të bartura	693	2529	17	35	17	11	3302
2	Lëndë të pranuar	20	210	2	1	0	0	233
3	Të gjitha lëndët në punë	713	2739	19	36	17	11	3536
4	Lëndë të zgjidhura	104	1616	0	0	0	0	1720
5	Lëndë të mbetura	609	1123	19	36	17	11	1815

### 1. Lëndë të reja të pranuar gjatë vitit 2026:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE								
	Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	Civile	Përbarimore	Konflikte administrative	Civile të ndryshme	Proc. at _hezionit	Komerciale ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara
1	Vërtetim i pronësisë	2	0					2
2	Kompensimet sipas Kontratës Kolektive	7	186					193
3	Konteste pune	1						1
4	Lëndë të tjera	8	24	2	1	0	0	35
5	Komuna paditëse/kreditore	2	1	0	0	0	0	3
	Gjithsej:	20	211	2	1	0	0	234

**2. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE**

<b>PARASHTRESA TË PRANUARA</b>	<b>CIVILE</b>	<b>PËRMBARIMORE</b>	<b>KONFLIKTE ADMINISTRATIVE</b>	<b>TË CIVILE NDRYSHME</b>	<b>P_Athezionit</b>	<b>Komerciale Ekonomike</b>	<b>GJITHSEJ:</b>
Aktvendim+Aktgjykim I	77	6	2	1	0	4	90
Aktvendim+Aktgjykim II	103	1	1	0	0	0	105
Atkvendim+Aktgjykim III	0		0	0	0	0	0
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	3						3
Urdhër përmbarimor		442					442
Aktvendim E për lejmim e përmbarimit		7					7
Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	20		2	1		0	23
Aktvendim për përgjigje në padi	20		2	1		0	23
Përgjigje në ankesë C	5		0	0			5
Përgjigje në ankesë P		0				0	0
Përgjigje në prapësim		0					0
Përgjigje në revizion	0		0	0		0	0
Përgjigje në propozim për ML	0		0	0		0	0
Precizim i padisë	1		0				1
Prapësim i debitorit		0					0
Ankesë C e paditësit	12						12
Ankesë P e kreditorit		3					3
Revizion C i paditësit	0		0	0		0	0
Ekspertiza	9	3	0	0		1	13
AktakuzA					0		0
Parashtresat e tjera	10	0	0	1		0	11
	<b>260</b>	<b>462</b>	<b>7</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>738</b>

Të gjitha shkresat e pranuar janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës varësisht nga rasti. Vendimet e pranuar gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës, janë ankimuar në shkallë tjetër gjyqësore.

<b>PARASHTRESA TË DËRGUARA</b>	<b>CIVILE</b>	<b>PËRMBARIMORE</b>	<b>KONFLIKTE ADMINISTRATIVE</b>	<b>TË CIVILE NDRYSHME</b>	<b>P_Athezionit</b>	<b>Komerciale Ekonomike</b>	<b>GJITHSEJ:</b>
Ankesat	19	0	0	1	0	0	20
Përgjigje në ankesa	0		0	0		0	0
Përgjigje në padi	20		2	1		0	23

Mbrojtje në padi DHP GJS	0						0
Revizion	0		0			0	0
Përgjigje në revizion	0		0			0	0
Propozime për ML	0		0			0	0
Përgjigje në ML	0						0
Prapësime			1				1
Përgjigje në prapësime			0				0
Ushtrimi i kundërpërbarimit			0				0
Ushtrimi i padisë	2		0			0	2
Kundërpadi	0						0
Kallëzim penal						0	0
Ushtrimi i propoz. për përbarim			1				1
Parashtrësit e tjera	11	0	0	0	0	0	12
Gjithsej:	52	2	2	2	2	0	59

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

Seancat gjyqësore gjatë vitit 2026	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej:
Nr. i seancave të mbajtura:	6	12	20	10	8	0	0	0	0	0	0	0	56
<b>Sipas kontesteve - seanca të caktuara/të mbajtura</b>													
Civile	47												
Përbarimore	0												
Konflikte administrative – komerciale ekonomike	8												
Civile të ndryshme	1												
Proc. at hezionit	0												
Gjithsej:	56												

## Zyra për Informim

Janë publikuar aktivitete-dokumente:

Lajme	Njoftime	Dok. financiare	Thirrje	Konkurse	Plane	Takime/dëgjime konsultime	Raporte	Vendimet e Kryetarit	Aktivitete gjithsej:
150	40	40	6	10	2	16	24	213	501

## Lektorimi

---

Zyrtarja për lektorim, ka redaktuar dokumentet e nxjerra nga Kryetari i Komunës, që ka lëshuar Zyra Ligjore, të tjera që kanë ardhur nga drejtoritë, duke përfshirë kërkesa për ministri, nga Kuvendi Komunal dhe nga komitetet e Kuvendit (procesverbale dhe vendime), si dhe dokumente të tjera të adresuara. Gjithsej, janë redaktuar: 450 dokumente.

Zyrtarja për lektorim merret edhe me: përpilimin e gazetës zyrtare mujore; raportin e punës së kryetarit; me redaktimin e listës së aktiviteteve të kryetarit etj.

### **Zyra e Auditimit të Brendshëm**

Gjatë kësaj periudhe kemi arritur t'i kryejmë 2 auditime dhe një është në proces.

Auditimet e brendshme të kryera në: Zyrën e Prokurimit, Drejtorinë për Shërbime Publike dhe në proces auditimi është Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

### **Zyra e Prokurimit**

Kemi proceduar **njëzet e pesë (25)** aktivitete të prokurimit në vlerën **2,873,052.00 €**; Janë nënshkruar **gjashtë (6)** kontrata të të gjitha prokurimeve: **punë, furnizime, shërbime**, në vlerën: **643,730.50 €**; **Një (1)** aktivitet i prokurimit është anuluar. **Tetëmbëdhjetë (18)** aktivitete të prokurimit janë në procedura të prokurimit, sipas Ligjit të Prokurimit Publik; Personeli i Zyrës së Prokurimit ka proceduar: **575 urdhërblerja**, pagesa të ndryshme të investimeve kapitale, mallra dhe shërbime.

### **Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim**

Aktivitete të shumta për mbështetjen e komuniteteve joshumicë dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar. Janë trajtuar 7 raste të riatdhesimit. ZKKK ka bashkëpunuar me institucione vendore dhe qendrore, duke përfshirë gjykatat, Zyrën e Kryeministrit dhe organizata të ndryshme, si dhe ka raportuar për zbatimin e planeve të integrimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Stafit ka marrë pjesë në trajnime profesionale për të drejtat e komuniteteve, integrimin e të huajve, barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna.

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

### Sektori i Gjendjes Civile

Gjatë këtij viti, janë lëshuar këto dokumente:

Certifikata të lindjes	5132
Ekstrakte të lindjes	6547
Deklarata të bashkësisë familjare	1152
Certifikata të martesës	2491
Certifikata të shtetësisë	55
Certifikata të vendbanimit	1073
Certifikata të vdekjes	1430
Vërtetime nga arkivi	261

Lindjet vendore	52
Lindjet e jashtme	394
Martesa vendore	401
Martesa e jashtme	91
Martesa me shtetësi të huaj	39
Vdekjet vendore	81
Vdekjet e jashtme	59
Aktvdekjet	414
Pranimi i atësisë	11
Aktvendim - korrigjimi i emrit personal	16
Aktvendim - regjistrimi i lindjes së mëvonshme	3
Aktvendim - regjistrimi i vdekjes së mëvonshme	51
Aktvendim - ndërrimi i emrit personal	42
Aktvendim - Anulimet e regjistrimeve të dyfishuara	6
Aktvendim - reregjistrimi i vdekjes	18
Aktvendim - reregjistrimi i lindjes	5

Të hyrat financiare në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme për këtë periudhë janë: 29,739.00 euro.

### Sektori për Punë të Kuvendit dhe të Komiteteve

Më poshtë paraqitet në formë tabelore numri i mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve të dala nga Kuvendi i Komunës për periudhën e vitit 2026:

Nr.	Kuvendi dhe trupat e tij	Mbledhjet e rregullta të Kuvendit	Seancë përkujtimore	Solemne	KPF	KKSB	K. për Komunitete	K. për Persona me Aftësi të kufizuara
1.	Numri i takimeve	5	0	1	4	2	2	2

	Emërtimet	Nr. i pikave të shqyrtuara	Konf. e ligjshmërisë nga MAPL-ja	Rishqyrtime të ligjshmërisë nga KK-ja
1.	Mbledhjet e rregullta të Kuvendit	59	31	5

### Sektori për IT

Rikonfigurimi i kompjuterëve; inspektimi i pajisjeve kompjuterike; monitorimi i sistemit të intranetit; performanca e faqes ueb zyrtare – publikimi i materialeve të ndryshme; mbështetja teknike e mbledhjeve të ndryshme në Kuvendin Komunal; mbikëqyrja e funksionimit të pajisjeve për printim, kopjim dhe skanim; funksionaliteti i pandërprerë i e-kiosqeve dhe “one stop shop”-it.

## Qendra për Shërbime me Qytetarë

Mbajtja e dosjeve, e statistikave të parashtrësive dhe të kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypja e librit të protokollit për kërkesat/parashtrësit etj.

Kërkesat e pranuar:

Drejtoria për Administratë	shenja e klasifikimit	nr. i kërkesave	të paguara	të liruar	gjithsej:
Kërkesa/ankesa	320/04	3648		225	3,903
Mbajtës familjeje	040/01	633/10euro	633	//	6,330
Vërtetime të ndryshme	320/04	229/2euro	149	80	149
Referenca	320/04	4/50 euro	4		200

## Spektori për Mirëmbajtje, Logjistike dhe Sigurim të Objekteve

Ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj.); menaxhimi i automjeteve (mirëmbajtja, servisimi, sigurimi, regjistrimi i tyre, furnizimi transparent me derivate etj.).

## Spektori për të Drejtat e Njeriut

Bashkëpunime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; këshillime të qytetarëve të cilët janë paraqitur në zyrë; bashkëpunim të ngushtë me zyrën e Avokatit të Popullit, me të cilët është punuar me theks të veçantë kundër diskriminimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, pa dallim etnie e gjinie.

## Spektori për Barazi Gjinore

Angazhimi në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrime të barabarta të gruas ashtu siç parashihen me ligjet në fuqi dhe me konventa ndërkombëtare.

Bashkëpunime me organizata vendore dhe të huaja; punëtori të ndryshme.

Spektori për Barazi Gjinore, ka objektiv rritjen e rolit të gruas në shoqëri.

## DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

### BUXHETI 2026

➤ **Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2026 ndahet në dy fonde burimore:**

- Granti qeveritar ..... 19,296,320 €
- Të hyrat vetanake ..... 2,251,414 €
- Gjithsej: 21,547,734 €

➤ **Buxheti final për vitin 2026 i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:**

- Paga dhe Mëditje ..... 12,454,555 €
- Mallra dhe Shërbime..... 2,761,006 €

- Shpenzime Komunale ..... 390,000.00€
  - Subvencione dhe Transfere ..... 1,000,000 €
  - Investime Kapitale..... 4,942,173 €
- Totali: 21,547,734 €**


➤ **Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar këto detyra:**

- Zotime, pranime, shpenzime për mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale;
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2026 për Kuvendin Komunal dhe për Kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në faqen ueb të Komunës.

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/buxheti aktual %	Shpenzim/alokim %
Paga dhe Mëditje	-	12,454,555.00	12,454,555.00	6,041,384.04	6,041,384.04	48.51	100.00
Mallra dhe Shërbime	1046	2,761,008.00	2,931,008.00	2,731,008.00	1,634,042.30	55.75	59.83
Shpenzime Komunale	164	390,000.00	425,539.62	425,539.62	215,291.15	50.59	50.59
Subvencione dhe Transfere	83	1,000,000.00	1,050,000.00	538,879.00	493,984.25	47.05	91.67
Investime Kapitale	10	4,948,540.66	5,314,540.66	4,424,361.51	3,484,892.93	65.57	78.77
<b>Totali:</b>	<b>1303</b>	<b>21,554,103.66</b>	<b>22,175,643.28</b>	<b>14,161,172.17</b>	<b>11,869,594.67</b>	<b>53.53</b>	<b>83.82</b>

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2025, donacionet dhe grantet.

## Paraqitja grafike



## TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2026, janë 2,251,414.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumën 707,229.48 € apo 31.41 % të planifikimit vjetor.

## SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra në shumën prej 305,593.70 euro apo 39.20 % vjetor (planifikimi vjetor 779,432.00).
- Regjistrimet e reja janë 130 objekte, ose 22,520 m<sup>2</sup>. Verifikimi i objekteve: 2658 ose 442,943 m<sup>2</sup>.

\*Për arsye të përditësimit të programit të tatimit në pronë nga Departamenti i Tatimit në Pronë, nuk ka qenë e mundur të gjenerohen të gjitha të dhënat e kërkuara për këtë raport.

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

- Është bërë i përhershëm ofrimi i shërbimeve mjekësore me dy ndërrime në dy Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) në Krushë të Madhe dhe Ratkoc;
- o vazhdon me sukses shërbimi "Kujdesi Shtëpiak" për të moshuarit dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar. Ekipi i përbërë nga një mjek dhe dy infermierë ofron shërbime në terren çdo ditë nga ora 07:00 deri në 21:00;
- Janë kryer vizitat sistematike mjekësore për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës së Rahovecit. Po ashtu, janë shpërndarë ftesat për vaksinimin e rregullt të fëmijëve dhe është shënuar Java e Imunizimit;
- Është në funksion të plotë aparati i mamografisë në mjekësinë primare, një investim direkt dhe jetik për shëndetin e grave dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit.
- Janë shqyrtuar me kohë kërkesat e qytetarëve, me ç'rast janë miratuar mbi 200 kërkesa për ndihma momentale financiare;

- Janë përkrahur financiarisht dhe logjistikisht organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale në komunë;
- Me qëllim avancimin e shërbimeve, janë pranuar 4 mjekë të rinj dhe procesi është në vijim e sipër edhe për 3 pozita të tjera të mjekëve të përgjithshëm;
- Janë mbajtur ligjërata vetëdijësuese në QKMF Rahovec, janë organizuar aksione për dhurimin vullnetar të gjakut (në Dejnë, Ratkoc dhe Krushë të Madhe), si dhe ka filluar procesi i dezinfektimit komunal (përfshirë dezinfektimin kundër rriqrave).
- *Gjatë këtij gjastëmujori, të hyrat e gjeneruara nga QKMF-ja kapin vlerën prej 33,050.00 euro.*

## **DREJTORIA PËR ARSIM**

- U realizua furnizimi i rregullt me lëndë djegëse në të gjitha shkollat. U sanuan defektet e ngrohjes në shkollën “Skënder Kastrioti” (ndërrimi i kabllit të djegur) dhe në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori” (blerja e aparatit përforcues të tensionit);

- Kanë rifilluar punimet kapitale për finalizimin e objektit të SHFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc;

- U rregullua një pjesë e rrethojës në ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori”;

- U sigurua një donator nga Krusha e Madhe për ndërtimin e parkingut në oborrin e çerdhes “Tulipanët”;

- Marrëveshje mirëkuptimi për projektin WEMPOWER (financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim) për aftësimin profesional dhe ndërmarrësinë e grave në shërbimet edukative të fëmijërisë së hershme.

- Marrëveshje me ShPIK-un për përfshirjen e nxënësve në iniciativat globale: *Hour of Code*, *Hour of AI* dhe *Bebras Computing Challenge*;

- U hartua dhe u zbatua Plani i Veprimit për aktivitetet e psikologëve dhe pedagogëve shkollorë për ofrimin e shërbimeve të barabarta dhe parandalimin e dukurive negative;

- U formua dhe funksionalizua Komisioni për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta (u shqyrtuan rastet për dy nxënës në Ratkoc dhe një nxënës në Hoçë të Vogël).

- U realizuan vizita sistematike shëndetësore për nxënësit e klasave të para dhe të pesta;

- U organizuan kuize të diturisë;

- U hap konkursi për bursa për nxënësit e shkollave të mesme dhe për studentë (faza e mbledhjes së të dhënave).

## DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

### Sektori për Ekonomi

Të hyrat në taksa komunale:

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	Rritja në %
1.	Të hyrat në taksa komunale	31.857.50 €	63.021.50 €	97.82%

### Sektori për Zhvillim

Në periudhën janar-qershor, janë lëshuar gjithsej 33 pëlqime të punës.

Të hyrat nga qiratë:

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	Rritja ne %
1.	Të hyrat nga qiratë	25.474.64 €	40.761.97 €	60 %

### Zyra e QKRB-së

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar - qershor 2026:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1.	Biznese të reja	25
3.	Biznese të reja Sh. P. K.	49
4.	Informata të bizneseve	64
5.	Shuarje të biznesit	9
7.	Lëndë të anuluar	0
8.	Certifikata duplikate	6
9.	Historiat biznesi	0
10.	Ndryshime në biznes	45
11.	Vërtetim individual	2
	Gjithsej lëndë të përfunduara:	200

### Menaxhimi i aseteve komunale

Sistemimi i të dhënave: U përditësua sistemi zyrtar SIMFK (përfshirë të dhënat e viteve paraprake) dhe u krijua një bazë e re të dhënash në Excel për arkivim digjital dhe menaxhim më efikas.

Evidentimi i pasurive: Gjatë muajit mars 2026, u identifikuan dhe u regjistruan të gjitha pasuritë jashtë përdorimit nëpër shkollë, QKMF dhe në administratën komunale.

Shitja e automjeteve: U identifikuan 9 automjete jashtë përdorimit; u shitën 7 lote (loti 1 dhe loti 7 mbetën të pashitur); realizuan 6,532.00 € të hyra nga kjo shitje.

### Sektori i Turizmit

- Takime me prodhues të verës;
- Kontakte me organizata si UNDP, KIESA, KFOR;
- Bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjës për agroturizëm;

- Takim virtual me Ministrinë e Turizmit të Burundit, e cila ka marrë Rahovecin si model të praktikave të mira për zhvillimin e turizmit të tyre;
- U hartua projekti “Zbulo Rahovecin – promovimi i turizmit”;
- Po krijohet platforma digjitale “Rahovec Tourism”;
- Përditësimi i pikave turistike për sinjalizim rrugor sipas udhëzimeve administrative.

## **DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**

---

Të hyrat buxhetore:

	2022	2023	2024	2025	2026
hyra janar- qershor	6,343.17	13,601.06	23,531.33	22,307.45	29,750.1

### **Sektori i Urbanizmit dhe i Planifikimit**

---

kërkesat	janar - maj 2026				
	nr. total	miratuar	refuzuar	në shqyrtim	të hedhura
leje ndërtimi	20	19	0	1	0
leje përdorimi	3	3	0	0	0
leje rrënimi	9	6	0	3	0
kushte ndërtimore	39	25	0	12	2
kërkesa	46	18	3	25	0
Vërtetim urbanistik	11	5	2	3	1
legalizim i objekteve	2	2	0	0	0
<b>gjithsej</b>	<b>130</b>	<b>78</b>	<b>5</b>	<b>44</b>	<b>3</b>

Të hyrat e përgjithshme

parallogaria	18426.32 €
vërtetime - pëlqime	735 €
legalizim	5420.58 €
<b>totali i të hyrave</b>	<b>24581.90 €</b>

## Sektori i Mjedisit

janar-maj 2026					
	nr. total	miratuar	refuzuar	në shqyrtim	të hedhura
leje mjedisore	15	13	2	0	0
<b>gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>13</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>totali i të hyrave</b>				<b>5168.24 euro</b>	

- Hartimi i Hartës Zonale 2026–2033; Ndërtimi i Sheshit Qendror në Qytet; Ndërtimi i kullës në Retijë; Ndërtimi i kolektorit dhe i shtratit të lumit Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushë e Madhe.

### DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

- Kanë rifilluar punimet për ndërtimin e rrugëve lokale. Është në përfundim ndërtimi me elemente betoni i një rruge me gjatësi prej 175 metrash në fshatin Gexhë, si dhe janë drejt përfundimit edhe dy segmente të tjera rrugore;
- Kanë filluar punimet në rrugën Sarosh–Rahovec (aktualisht po realizohet nënbaza e rrugës);
- Po vazhdojnë punimet në rrugën **Sapniq–Nashpallë–Vrajak** (pas përfundimit të lëshesave gypore do të vijojë asfaltimi);
- Rruga me katër korsi: Kanë filluar përgatitjet në teren për largimin e rrjetit elektrik dhe shtyllave ekzistuese;
- U realizuan intervenime emergjente për zhblokimin e rrugëve në Kaznik, Fortesë, Brestoc, Pastasel, Kramovik dhe Xërxë, si dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve pas vërshimeve;
- Po vazhdon projekti i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (programi IPA), në partneritet me Komunën e Haraçinës, për ndërtimin e 6 gropave septike, ku punimet kanë nisur në fshatrat Drenoc dhe Senoc;
- Është intervenuar në rrugën “Vëllezërit Haradinaj” për rregullimin e rrjetit të kanalizimit;
- Është intervenuar në rregullimin e disa pusetave në rrugët “Bekim Isma”, “Dëshmorët e Pashtrikut”, si dhe në lagje të tjera.
- Ka përfunduar krasitja e drunjve dekorativë dhe pastrimi i vegjetacionit në qytet. Janë kryer ndërhyrje në ndriçimin publik (shtylla dhe pajisje përcjellëse), si dhe janë rregulluar kabllot e kamerave të sigurisë dhe sinjalistika rrugore;
- Po vazhdon pastrimi i kanaleve dhe përroskave në Malësi të Vogël, Xërxë, Zoqishtë dhe lokalitete të tjera. Në MMPHI është dorëzuar lista e përroskave që kërkojnë ndërhyrje.

### DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

- Pranimi dhe dorëzimi i aplikacioneve në Ministri për thirrjen për subvencionim të qumështit dhe blegtorisë: 90 blegtorë;
- Përkrahje për grumbulluesit dhe përpunuesit e perimeve (trangull kornishan dhe spec): është nënshkruar kontrata për mbulimin e inputeve bujqësore (fidanë, plehërim, pesticide, folie, ujitje pikë-pikë);
- Përkrahje e fermerëve me pleh artificial: kanë aplikuar 1.146. Pas verifikimit në programin Elpis (për vitin 2025), janë shpallur 1.130 përfitues, të ndarë në dy faza (me 20 % participim);
- Luftimi i insektit “cikadia” dhe trajtimi me dronë në vreshta: aplikimi do të vazhdojë deri më 12 qershor.
- Në bashkëpunim me “Agrocelina”, është bërë shpërndarja e materialeve të ndryshme për serra, si: sisteme ujitjeje, pleh, pesticide etj. Projekti subvencionohet 80% nga Drejtoria dhe 20% nga

kompania. Do të mbështeten **150 fermerë** me rreth **500,000 fidane** në një sipërfaqe prej **12 hektarësh** (7 ha tranguj dhe 5 ha speca kortosk).

- Janë realizuar vizita të rregullta në stalla, fidanishte, serra dhe pika grumbulluese;
- Nga veterinari i punësuar në DBPZHR është kryer vaksinimi falas i kafshëve me vaksinën Cubolac:  
Janë vaksinuar gjithsej **2,126 bagëti të trasha** (gjatë shkurtit);  
Janë vaksinuar gjithsej **7,320 bagëti të imta** (gjatë majit).
- Është dhënë leje për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore për ndërtimin e një **parku solar të energjisë**, duke realizuar të hyra në buxhetin e Komunës;
- Pas kërkesave të shumta, komisionet zyrtare kanë bërë vlerësimin e dëmeve në bujqësi në terren. Vlera totale e dëmeve të konstatuara sipas kërkesave ka arritur në **165,178.64€**;
- Janë sanuar dhe rregulluar rrugët fushore në këto lokacione:
  - Fshati Polluzhë (lokacioni “Livadhet e Morinëve”).
  - Fshati Drenoc (te Kroj i Demirit dhe rruga Zhagavica).
  - Rahovec (zonat e vreshtave në Hamoc dhe Bernjak).
  - Fshati Celinë.
  - Fshati Radostë.
- Pastrime përrrenjsh: Në fshatrat Zaqisht, Xërxë, Celinë, si dhe në Rahovec (rruga për në Brestoc – pastrim nga mbeturinat dhe ujërat e zeza);
- Intervenime emergjente në kanale kulluese pas reshjeve në Xërxë, Fortesë, përgjatë hapësirës Fortesë–Celinë, si dhe në Senoc (ku përveç pastrimit janë rregulluar edhe 3 ura me gypa fi 1200).
- Sipas planit, vazhdojnë punimet për ndërtimin/rregullimin e depos bujqësore.

## **DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË**

---

Janë trajtuar kërkesa të shumta dhe janë lëshuar dokumente të ndryshme sipas kërkesave të palëve:

Trashëgim: 139; Kontrata shitblerjeje: 128; Kontrata dhurimi: 64; Kontrata këmbimi: 6; Kontrata qiramartjeje: 16; Kontrata ndarje fizike: 7; Marrëveshje ndërmjetësimi: 147; Aktgjykim: 17; Hipoteka: 14; Çregjistrime të hipotekës: 14; Historiate: 12; Azhurnime: 29; Barra tatimore: 5; Bashkim ID: 26; Modifikim i ID-së: 17; Ndarje të parcelave: 54; Bashkime të parcelave: 61; Bashkime dhe ndarje: 6; Koordinata: 141; Legalizime: 3; Vendime për uzurpime: 2; Servitut: 1; Regj. i pjesës së ndërtesës: 4; Certifikata të pronës: 366; Kopje të planit: 27; Kërkesa për social: 46; Kërkesa për vërtetim që nuk posedon pronë: 17; Kërkesa për dy certifikata: 50; Kërkesa për dy kopje të planit: 17; Kërkesa për certifikata të pronës dhe kopje të planit: 4; Modifikimi i attributeve të parcelës: 1.

## **DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

---

- Mbështetja e 34 OJQ-ve përmes thirrjes publike për subvencionim, në vlerë prej 243,000 euro, krahasuar me vitin e kaluar, kemi një rritje prej **10%**;
- Aktivitete përkujtimore e kulturore; Festivali “Anadrinia Jehon”;
- Vazhdimi i investimit dhe monitorimi i punëve në objektin e Qendrës Rinore dhe Kulturore; PALESTRA E SPORTEVE “MIZAHIR ISMA” - Për herë të parë është zhvilluar ndeshja ndërkombëtare në futbal në mes të kombëtares së Shqipërisë dhe të Danimarkës; Zhvillojnë ndeshjet klubet e hendbollit, të futbollit, të basketbollit etj. Zhvillohen aktivitete e turnirë të ndryshëm.
  - **BIBLIOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI”-RAHOVEC**
  - Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;

- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Shërbime me libra: 498 vajza dhe 321 djem.

Fondi total i librave në bibliotekën komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, është: 29254 libra. Në bibliotekën në Rahovec janë: 22832 libra, në Krushë të Madhe: 4570 libra dhe në Ratkoc: 1852 libra.

## **DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE**

---

### **INSPEKTORATI I NDËRTIMIT**

- Janë evidentuar dhe ndërprerë punimet në raste të ndërtimeve pa leje; Janë lëshuar vendime për rrënim në rastet e mosrespektimit të urdhrave; është realizuar mbikëqyrje e vazhdueshme e standardeve të ndërtimit; janë shqiptuar dhe ekzekutuar 45 gjoba mandatore për ndërtime pa leje.

### **MENAXHIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE**

- Janë identifikuar subjektet që shfrytëzojnë hapësirat publike pa leje; 93 subjekte janë obliguar të pajisen me leje përkatëse; 53 subjekte kanë përbushur obligimet, ndërsa 40 të tjera janë në proces.

### **INSPEKTORATI I MJEDISIT**

- Janë realizuar kontrolle të rregullta nga inspektori i mjedisit; janë shqiptuar 34 gjoba mandatore për ndotje të mjedisit; 23 subjekte janë obliguar të pajisen me leje mjedisore; është monitoruar zbatimi i akteve për menaxhimin e mbeturinave dhe automjeteve të vjetra.

### **INSPEKTORATI I TREGUT DHE I EKONOMISË INFORMALE**

- Janë intensifikuar kontrollet ndaj aktiviteteve ekonomike, si rezultat, 38 biznese janë formalizuar dhe regjistruar; janë lëshuar 20 pëlqime pune për subjektet që plotësojnë kushtet; janë kontrolluar 50 biznese për respektimin e çmimeve dhe deklarimit të produkteve; janë shqiptuar 8 gjoba mandatore për mos respektim të orarit të punës.

### **TRANSPORTI PUBLIK**

- Është monitoruar funksionimi i transportit publik dhe zbatimi i orareve; Janë kryer kontrolle ndaj operatorëve dhe autotaksive; janë dhënë udhëzime për rinovim të dokumentacionit.

## DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int. e tjera janar-qershor 2026							
2026	Nr. i përgj. i daljeve	Nr. i zjarreve	Nr. i teknike	Nr. i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Gjithsej:
Janar	44	8	21	3	1	11	44
Shkurt	12	7	1	4	0	0	12
Mars	33	20	4	8	1	0	33
Prill	16	8	0	7	1	0	16
Maj	23	4	3	9	5	0	23
Gjithsej:	128	48	29	31	8	11	128

